



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 1157

Datë 29.07.2019

Në mbështetje të nenit 23 dhe nenit 206 paragrafi 1, të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 3.7.2019, mori:

VENDIM

- I. Për themelimin e Qendrës për Zhvillim të Karrierës (QZHK) në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Misioni, vizioni dhe funksionet e kësaj Qendre janë të përcaktuara në projektin e themelimit të Qendrës dhe janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- III. Deri në krijimin e kushteve për funksionim të pavarur të saj, kjo qendër do të funksionojë në kuadër të Zyrës për informim me publikun.
- IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Këshilli Drejtues, pasi shqyrtoi propozimin e Ahmet Jasharit, drejtor i Zyrës për informim me publikun në UMIB, për themelimin e Qendrës për Zhvillim të Karrierës (projekt-propozimi me nr. prot. 1331, të dt. 02.07.2019), e konsideroi të arsyeshme kërkesën, duke pasur parasysh misionin, vizionin, funksionet dhe rolin e kësaj qendre. Projekti i Qendrës për Zhvillim të Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe deri në krijimin e kushteve për funksionim të pavarur të saj, kjo qendër do të funksionojë në kuadër të Zyrës për informim me publikun. Bazuar në këto që u cekën si më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Menaxhmentit
3. Të përmendurit
4. Shërbimit financiar të UMIB-it



Dr. sc. Ali Topalli

Kryesues i Këshillit Drejtues